



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:251201

Datë: 13.03.2025

Numri i dokumentit: 06987157

C.nr. 2587/2019

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Florian Krasniqi në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.B., të cilin e përfaqëson avokat B.A., me adresë në Rr “A.R.”, A, nr. Prishtinë kundër të paditurës K.S.“S.”, me seli në Prishtinë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, me datë 13.03.2025 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

- I.** APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.B. dhe DETYROHET e paditura K.S. “S.”, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material, të shkaktuar në aksidentin e datës 11.05.2019, për 50% të përgjegjësisë në shkaktimin e aksidentit, t’ia paguaj shumën prej 231.25€, me kamatë ligjore prej 8% në vit, e cila do të filloj të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë datë 31.07.2019 e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.
- II.** REFUZOHET si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditësit A.B., mbi shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit dhe atë shumën prej 231.25 euro, të kërkuar në emër të dëmit material për dëmin e shkaktuar në aksidentin e datës 11.05.2019.
- III.** DETYROHET e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 500.8 €, në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi për kompensim të dëmi ndaj të paditurës. Në padi ndër të tjera ka theksuar se, me datë 11.05.2019 te semaforat e fakultetit teknik në Prishtinë është shkaktuar aksident komunikacioni në mes të veturës audi A4 me targadhe paditësi i cili ka drejtuar motoçikletën e markës SYM pa targa. Ka theksuar se automjeti i paditësit është dëmtuar në masë të madhe dhe se shkaktari i aksidentit është i siguruari i të paditurës, andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të aprovet në tërësi si e bazuar.

E paditura në përgjigje në padi dhe në seanca gjyqësore ka deklaruar se, për të paditurën në këtë çështje juridike është kontestuese në tërësi baza juridike e kërkesëpadsisë dhe në veçanti fillimisht të metat procedurale që kanë të bëjnë me legjitimitetin e palës paditëse në procedurë, pasi që tani pala paditëse me asnjë provë të vetme nuk e ka dëshmuar se është pronar i mjetit motoçikletës për të cilën kërkon kompensim. Ka shtuar se lidhur me provat e dorëzuara nga pala paditëse e që janë kontrata për shitblerjen mes pronarit legjitim B. sh.p.k dhe paditësit, e njëjta kontratë nuk është formale dhe asnjë provë nuk mund të argumentohet se kjo kontratë është lidhur para datës së aksidentit pasi që palët kanë mundur të vendosin çfarëdo date në këtë shkresë të cilës i janë referuar kontratë. Tutje ka theksuar se e njëjta kontratë nuk mund të shërbej as për regjistrimin e mjetit pranë organeve kompetente, edhe fatura e dorëzuar si provë si e tillë nuk është e rregullt pasi që nuk përmbushë kushtet për një dokument të rregullt, pasi që e njëjta nuk e ka edhe dëshminë e pagesës si dhe nuk ka dëshmi se e njëjta është e evidentuar pranë institucioneve financiare në këtë rast ATK, po ashtu nuk ka asnjë dëshmi që e konstaton se tani paditësi e ka bërë pagesën e të njëjtës faturë, përmes formave të rregullta ligjore. I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadsia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata, bazuar në propozimet e palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit, dhe në këtë çështje juridike kontestimore ka administruar provat si në vijim: raporti policor 2019-AR-928, i datës 11.05.2019, së bashku me shtojcën, skicën dhe fotografitë, kontratë mbi shitblerjen nr. 017/2019 e datës 30.03.2019, fatura me nr.30032019-1, e datës 30.03.2019, urdhërpagesë e doganës e datës 13.12.2018, pagesë e datës 13.12.2018, libreza e automjetit 20.09.2000, dokumenti unik doganor e datës 13.12.2018, konfirmimi i sigurimit datë 29.05.2019, ekspertiza e komunikacionit e datës 29.11.2024, ekspertiza e makinerisë e datës 29.11.2024.

Gjykata, pasi bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në nenin 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim si: LPK), erdhi në përfundimin se padia e paditësit është pjesërisht bazuar, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Nga provat e administruara, gjegjësisht nga raporti policor 2019-AR-928, i datës 11.05.2019, rezulton se me datë 11.05.2019 ka ndodhur aksident i komunikacionit në mes të paditësit dhe të siguruarit të të paditurës.

Meqenëse e paditura e kontestuar bazën juridike të kërkesëpadsisë gjegjësisht e ka kontestuar faktin se i siguruari i saj është shkaktari i aksidentit të datës 11.05.2019, gjykata me propozimin e përfaqësuesit të paditësit ka bërë nxjerrjen e provës me ekspertizë të komunikacionit, e punuar nga eksperti i komunikacionit S.B., i cili në mendimin dhe konstatimin e tij të dhënë në ekspertizën e datës 29.11.2024 ka konkluduar se të dy pjesëmarrësit me veprimet e tyre kanë kontribuar në mënyrë të barabartë për shkaktimin e aksidentit të komunikacionit, duke theksuar se lëshimet e ngasës të automjetit "A" përfshijnë veprim – kyçje të pasigurte në udhëkryq nën dritën e semaforit të kuq, ndërsa veprimet – lëshimet e ngasës të motoçikletës "B", - këtu paditësit përfshijnë veprim – kyçje të pasigurte në udhëkryq, nën dritën e semaforit të kuq. Gjykata ekspertizën e ekspertit të komunikacionit e konsideroj të besueshme dhe profesionale,

të hartuar brenda vëllimit të detyrave të caktuar nga gjykata, e ndaj të njëjtës po ashtu nuk kanë pasur vërejtje as palët ndërgjyqëse.

Çështja e kompensimit të dëmit përcaktohet me dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Ligji nr. 04/L-077 (në vijim referuar si: LMD). Neni 154 i LMD-së, përcakton: *Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Për dëmin nga sendet ose nga veprimtaritë, nga të cilat rrjedhë rreziku i shtuar i dëmit për rrethin përgjigjet pavarësisht nga faji.*

Ndërsa me nenin 159 paragrafi 1 i LMD-së, parasheh: *Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit ndërsa me paragrafin 2 të të njëjtit nen është rregulluar: 2. Në qoftë se ekziston faji i dyanshëm, secili zotëruesi i mjetit motorik përgjigjet për dëmin e tërësishëm që e kanë pësuar ata përpjesëtimisht me shkallën e fajit të tyre.*

Bazuar në interpretimin e dispozitave të lartcituara rezulton se në rastet e aksidenteve nga mjetet motorike në lëvizje, secili automjet përgjigjet për dëmin e tërësishëm që e kanë pësuar ata përpjesëtimisht me shkallën e fajit të tyre. Në rrethanat e rastit konkret, nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, gjegjësisht nga ekspertiza e komunikacionit është vërtetuar se i siguruari i të paditurës dhe paditësi kishin kontribut të përbashkët në shkaktimin e aksidentit të datës 11.05.2019, andaj gjykata me zbatimin e nenit 154 të LMD-së, ka detyruar të paditurën që për 50% të kontributit në shkaktimin e aksidentit e paditura të detyrohet që paditësit ti paguajë shumën prej 231.25€.

Lartësinë e dëmit të shkaktuar në automjetin e paditësit, gjykata e ka vërtetuar përmes nxjerrjes së provës me ekspertizë nga lëmia e makinerisë, e cila është punuar nga eksperti i komunikacionit S.B., i cili në mendimin dhe konstatimin e tij të dhënë në ekspertizën e datës 29.11.2024 ka konkluduar se vlera e tërësishme dëmit të shkaktuar të motoçikletën që kanë duke e drejtuar paditësi është 462.50 euro.

Me rastin e vendosjes gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet e palës së paditur ku ka pretenduar se paditësi nuk është i legjitimuar që të kërkojë kompensimin e dëmit, ngase i njëjti nuk ka arritur të vërtetoj faktin se paditësi është pronar i motoçikletës të dëmtuar në aksident, megjithatë një pretendim të tillë gjykata e gjen të pabazuar. Kjo për faktin se së bashku me padi paditësi si prova për të vërtetuar pronësinë mbi motoçikletën ka bashkëngjitur kontratën mbi shitblerjen nr. 017/2019 e datës 30.03.2019 si dhe faturën me nr.30032019-1, e datës 30.03.2019, e që sipas vlerësimit të kësaj Gjykate këto prova janë të mjaftueshme për të vërtetuar faktin se paditësi ka blerë motoçikletën e dëmtuar në aksident, ndërsa sa i përket pretendimit të përfaqësuesit të të paditurës se Kontrata mund të jetë bërë më vonë dhe se e njëjta nuk është kontratë formale, gjykata i referohet Udhëzimit Administrativ (mpb) nr. 01/2018 për Regjistrimin e Mjeteve, i cili ka qenë në fuqi në kohën kur paditësi ka blerë automjetin dhe në nenin 6 të këtij udhëzimi janë të përcaktuara dokumentet që nevojiten për regjistrimin e automjetit për herë të parë dhe siç rezulton nga dispozita në fjalë, nuk kërkohet një kontratë formale – e noterizuar për regjistrimin e mjeteve për herë të parë, ndërsa siç shihet nga dokumenti unik doganor e datës 13.12.2018,

automjeti nuk ka qenë i regjistruar në Republikën e Kosovës asnjëherë. Tutje sa i përket pretendimit të përfaqësuesit të të paditurës lidhur me faturën nr.30032019-1, e datës 30.03.2019 se për të njëjtën nuk ka prova se është e deklaruar në Administratën Tatimore të Kosovës – ATK, gjykata vlerëson se kjo faturë është e lëshuar nga shitësi i motoçikletës tek paditësi, shoqëria tregtare B.Sh.p.k me numër të biznesit 810155590 dhe deklarimi i faturave nuk ka qenë obligim i këtu paditësit si blerës por i subjektit që lëshon fatura në këtë rast B.Sh.p.k.

Sa i përket pikës II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata ka refuzuar shumën 231.25 euro të kërkuar nga paditësi në emër të kompensimit të dëmit material. Kjo për faktin se siç është elaboruar më lartë në arsyetim të këtij aktgjykimi, nga ekspertiza e komunikacionit është konstatuar fakti se edhe paditësi kishte kontribut të barabartë në shkaktimin e aksidentit së bashku me të siguruarin e të paditurës. Në këtë situatë, gjykata i referohet nenit 159 paragrafi 2 i LMD-së, i cili përcakton se *2. Në qoftë se ekziston faji i dyanshëm, secili zotëruesi i mjetit motorik përgjigjet për dëmin e tërësishëm që e kanë pësuar ata përpjesëtimisht me shkallën e fajit të tyre.* Nga dispozita në fjalë rezulton se secili zotërues përgjigjet për dëmin që e ka pësuar përpjesëtimisht me shkallën e fajit të tij, andaj marrë për bazë se paditësi ka pasur kontribut të barabartë në shkaktimin e aksidentit, gjykata duke bërë ndarjen e përgjegjësisë në 50% për paditësin, ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë së paditësit në shumën prej 231.25€. Me rastin e vendosjes lidhur me pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë gjykata po ashtu u bazua edhe në dispozitën e nenit 176, paragrafi 1 të LMD-së e cila përcakton se *1. I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar.*

Lidhur me kërkesën për kumatën ligjore, Gjukata vendosi në kuptim të nenit 382 paragrafi 1 lidhur me paragrafi 2 të LDM-së, duke llogaritur rrjedhën e kumatës nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë 31.07.2019, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit. Gjukata ka caktuar për dëmin material datën e rrjedhjes së kumatës ligjore prej 8% vjetore, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë, duke u bazuar edhe në Mendimin Juridik për Kumatën të Gjukatës Supreme të Republikës së Kosovës GJ.A.Su.A.265/2020, dt.02.12.2020, ku në pjesën e tretë të këtij mendimi, gjegjësisht pikën XIV, përcaktohet: *“Pavarësisht kur është lindur marrëdhënia e detyrimeve, për kërkesat që i referohen dëmit material (dëmi material dhe fitimi i munguar), kamata fillon të rrjedhë nga data e parashtrimit të kërkesës së kreditorit për kompensimin (e pranuar nga debitori) dhe në rast të mos parashtrimit të kërkesës nga ana e kreditorit për kompensim, atëherë kamata fillon të rrjedh nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën e plotë”.*

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, duke marrë për bazë lartësinë e shpenzimeve për kontestet e vlerës së vogël, e që të njëjtat i referohen shumës së vendosur si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin: për padi shumën prej 78€, për përfaqësim në dy seanca nga 101,4€, për ekspertizë të komunikacionit dhe të makinerisë shumën prej 200 €, për taksën gjyqësore për padi 20 €, të gjitha në shumë prej 500,8 €.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, bazuar në nenin 160 të LPK-së, gjykata ka vendosur si

në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.2587/2019, datë 13.03.2025

Gjyqtari
Florian Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.